

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE

BUXHETI 2027

për qytetarët

Një vështrim i thjeshtëzuar në financat publike për vitin **2027**

Ky material mbështetet në Projektligjin për Buxhetin e Vitit 2027 të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 806 datë 28.10.2026. Ky material paraqet një variant të përmbledhur dhe jo shterues të propozimit të buxhetit 2027.

Përdorimi i tekstit

Përdorimi i tekstit dhe të dhënave të paraqitura në këtë material, me kusht që të referohen pandryshim, lejohet me citimin e burimit:

Burimi: Ministria e Financave

Modifikimi i tekstit

Në rast se teksti, të dhënat apo grafikët e paraqitur këtu përdoren për të gjeneruar material apo të dhëna të ndryshme, preferohet citimi: Bazohet në të dhëna nga Ministria e Financave.

Informacione të tjera

Projektligji i plotë për Buxhetin 2027 dhe tabelat përkatëse janë botuar në faqen e internetit të Ministrisë së Financave:

www.financa.gov.al

Për informacione apo sqarime të nevojshme mund të drejtoheni në adresën: Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Ministria e Financave, Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë.

e-mail: budget.programming@financa.gov.al

Botimi i këtij dokumenti u mundësua nga Ministria e Financave

Tetor 2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

2027

BUXHETI PËR QYTETARËT

Një vështrim i thjeshtëzuar në financat publike për vitin 2027

Përmbajtja

BUXHETI PËR QYTETARËT 2027	4
MESAZH PËR LEXUESIN	5
TË DHËNA DEMOGRAFIKE	7
PUNËSIMI	8
RRITJA EKONOMIKE	9
TË ARDHURAT E BUXHETIT	10
SHPENZIMET E BUXHETIT	11
POLITIKAT PRIORITARE TË QEVERISË DHE FINANCIMI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR REALIZIMIN E TYRE	12
BUJQËSIA DHE ZHVILLIMIT RURAL	13
MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK	15
INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA	16
SHËNDETËSIA	18
ARSIMI	20
MBROJTJA SOCIALE	21
DREJTËSIA DHE RENDI	22
MBROJTJA	23
ARGËTIMI, KULTURA DHE ÇËSHTJET FETARE	24
MBROJTJA E MJEDISIT	25
STREHIMI	26
DEFICITI BUXHETOR DHE BORXHI PUBLIK	27

Mesazh për lexuesin



Petrit MALAJ

Ministër i Financave

Të nderuar qytetarë të Republikës së Shqipërisë,

Dëshiroj t'ju njoh shkurtimisht dhe në mënyrë të thjeshtuar me propozimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2027. Projektbuxheti 2027 është ndërtuar në përputhje me prioritetet e Qeverisë për periudhën 2025–2029 dhe vizionin për një Shqipëri Europiane, duke mbështetur zhvillimin ekonomik e social, rritjen e mirëqenies dhe reformat për përshpejtimin e integrimit në Bashkimin Europian. Ekonomia parashikohet të rritet me rreth 4% në vitin 2026 dhe me 3.9% në vitin 2027, ndërsa gjatë periudhës 2027–2029 rritja pritet të jetë mesatarisht rreth 4% në vit. Deficiti buxhetor për vitin 2027 planifikohet në 2.3% të PBB-së, ndërsa borxhi publik pritet të ulet nga 52.5% e PBB-së në vitin 2026 në rreth 52.4% në vitin 2027.

Projektbuxheti fokusohet në financimin me prioritet të sektorëve kyç, si arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe zhvillimi rural, mbrojtja sociale, infrastruktura, siguria dhe digjitalizimi. Investimet publike parashikohen në 200.3 miliardë lekë ose 6.8% të PBB-së, duke siguruar financimin e projekteve strategjike dhe atyre në vazhdim. Në këtë nivel përfshihen edhe 14.1 miliardë lekë financime të pritshme mbi bazë projektesh nga Plani i Rritjes i Bashkimit Europian për Ballkanin Perëndimor.

Për vitin 2027, të ardhurat totale buxhetore parashikohen në 907.8 miliardë lekë ose 30.9% të PBB-së, rreth 64.7 miliardë lekë më shumë se plani i rishikuar i vitit 2026. Të ardhurat nga tatimet dhe doganat parashikohen të rriten me 8.7%. Kjo rritje mbështetet në zgjerimin ekonomik, përmirësimin e administrimit tatimor e doganor, reduktimin e informalitetit, Paketën Fiskale 2027 dhe zbatimin e masave të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2024–2027.

Në krahun e shpenzimeve, për vitin 2027 parashikohen 976.1 miliardë lekë ose 33.3% e PBB-së, rreth 69.3 miliardë lekë më shumë se plani i rishikuar i vitit 2026. Vëmendje e veçantë i kushtohet politikave sociale dhe rritjes së mirëqenies. Për periudhën 2027–2029 sigurohen burimet për vijimin e politikës për rritjen e pensionit minimal në 200 euro dhe pensionit mesatar në 400 euro në muaj. Për vitin 2027 parashikohen 4 miliardë lekë për indeksimin e pensioneve dhe 20 miliardë lekë për bonusin mujor të pensionistëve. Gjithashtu, financohet politika e rishikuar e bonusit të bebes, me pagesë mujore për fëmijët e moshës 0–5 vjeç.

Në Projektbuxhetin 2027 do të vijojë adresimi i barazisë gjinore, veçanërisht në arsim, shëndetësi, mbrojtje sociale, drejtësi dhe rend publik. Rreth 9.1% e shpenzimeve buxhetore lidhen me politika publike me bazë gjinore, të përfshira në 82 programe buxhetore, me synim reduktimin e hendeqeve gjinore.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2027 parashikohen në 114.6 miliardë lekë, ose 2.4% më shumë se në vitin 2026, duke arritur në 3.9% të PBB-së. Transferta e pakushtëzuar rritet me 1.4 miliardë lekë ose 5.1% ndaj vitit 2026 dhe është 16.9 miliardë lekë më e lartë se në vitin 2015. Kjo mbështetje synon forcimin e decentralizimit dhe përmirësimin e shërbimeve vendore për qytetarët.

Projektbuxheti 2027 synon të përmirësojë jetën e përditshme të qytetarëve përmes mbështetjes së pensioneve dhe politikave sociale, investimeve në arsim, shëndetësi dhe infrastrukturë, si dhe ruajtjes së stabilitetit ekonomik e fiskal. Njëkohësisht, ai mbështet reformat dhe investimet që rrisin produktivitetin, konkurrueshmërinë dhe përshpejtojnë konvergjencën ekonomike dhe sociale të Shqipërisë me Bashkimin Europian.

Falemnderit

TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Popullsia e Shqipërisë në Janar 2026 rezulton 2.33 milion banorë, duke pësuar rënie me 1.2% krahasuar me 2026, nga të cilët:

2.33
Milionë



1,181,980 gra dhe vajza


50.6

Rreth 17% e popullsisë përbëhet nga gra/vajza dhe burra/djem të moshës 20-34 vjeç, prej të cilëve/cilave 50.6% janë gra dhe vajza (16.3% e të cilëve janë të moshës 25-29 vjeç).

1,153,950 burra dhe djem

49.4





Jetëgjatësia mesatare për vitin 2026 parashikohet të jetë **78.6 vjeç** për burra dhe **82.5 vjeç** për gratë

Tirana vijon të jetë qarku me popullsinë më të lartë në vend me 765,459 banorë, nga të cilët 396,319 gra dhe vajza (ose 52%) dhe 369,140 burra dhe djem (ose 48%) e ndjekur nga Fieri (227,654 banorë, 50% gra dhe 50% burra), Elbasan (222,278 banorë, 50% gra dhe 50% burra) dhe Durrës (220,074 banorë, 50% gra dhe 50% burra).

*ëëë.instat.gov.al- Treguesit demografik dhe social

PUNËSIMI




Referuar statistikave të INSTAT shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 69.3%.

76% për burrat
62.7% për gratë


Struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se:

Sipas vlerësimeve të anketës për vitin 2025 (vjetore), rezulton se për grupmoshën 15 vjeç e lart, 48 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 30.8% janë të vetë-punësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 21.1% janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.

Shkalla e Punësimit (15-64 Vjeç)
2025



Papunësia




Paga mesatare bruto për T2 2026 rezulton 92,150 lekë



RRITJA EKONOMIKE

Rritja ekonomike parashikohet në normën 4.0 përqind për vitin 2026, e mbështetur nga kushtet e favorshme ekonomike, performanca e qëndrueshme e sektorit të shërbimeve, veçanërisht turizmi, si dhe zgjerimi i konsumit privat dhe investimet në ndërtim e infrastrukturë. Në periudhën afatmesme 2027-2029, rritja parashikohet të ruajë trajektore pozitive, me një normë mesatare prej rreth 4.0 përqind në vit, e mbështetur nga dinamika e kërkesës së brendshme, zhvillimi i mëtejshëm i sektorëve strategjikë dhe pritshmëritë për një rikuperim gradual të ekonomisë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian.

Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme 2027 – 2029 parashikohet të rritet në terma real me mesatarisht rreth 2.8 përqind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.2 pikë përqindje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma real mesatarisht në rreth 5.6 përqind në vitet 2027-2029, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.4 pikë përqindje në vit.




Inflacioni mesatar pritet të qëndrojë stabël në nivelin 3% përgjatë 2027-2029 ndërsa Prodhimi i Brendshëm Bruto për banor (PBB/banor) pritet të rritet nga 1174.1 mijë lekë për banor në vitin 2026 në 1386.3 mijë lekë për banor në vitin 2027.

RRITJA EKONOMIKE 4%

*Produkti i Brendshëm Bruto

TË ARDHURAT E BUXHETIT

Në vitin 2027, të ardhurat totale të buxhetit të shtetit parashikohen të arrijnë 907.8 miliardë lekë (ose 30.9% të PBB), prej të cilave, të ardhurat tatimore zënë 853.5 miliardë lekë (ose 29.1% të PBB) dhe brenda zërit të të ardhurave tatimore, të ardhurat që mblidhen nga tatimet dhe doganat janë 583.5 miliardë lekë (ose 19.9% të PBB). Të ardhurat nga kontributet planifikohen të jenë 211.3 miliardë lekë (ose 7.2% të PBB).



2% e PBB

Të ardhurat nga pushteti vendor janë parashikuar në vlerën 58.6 miliardë lekë.

SHPENZIMET E BUXHETIT



976.1 miliardë lekë

- Mbrojtja Sociale – 279.7
- Shërbimet e Përgjithshme Publike * - 154.2
- Mbrojtja – 52.4
- Rendi dhe Siguria Publike – 65.5
- Mbrojtja e Mjedisit – 8.7
- Çështjet Ekonomike – 141.6
- Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit – 67.4
- Shëndetësia – 87.2
- Arsimi – 93.7
- Argëtimi, Kultura dhe Çështjet Fetare – 14.2
- Kontingjenca e Risqeve të Borxhit - 6.8

Projektbuxheti 2027 synon të mbështesë rritjen e mirëqenies së qytetarëve dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Për vitin 2027, shpenzimet buxhetore planifikohen në 976.1 miliardë lekë, ose rreth 33.3% e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), duke reflektuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin 2026. Një pjesë e rëndësishme e fondeve do të përdoret për forcimin e mbrojtjes sociale dhe rritjen e mbështetjes për familjet. Në këtë kuadër, parashikohen fondet e nevojshme për rritjen graduale të pensioneve, me synimin që pensioni minimal të arrijë në 200 euro në muaj dhe pensioni mesatar në 400 euro në muaj. Gjithashtu, buxheti mbështet reformimin e bonusit të bebes dhe krijimin e një skeme të re mbështetjeje financiare mujore për fëmijët e moshës 0-5 vjeç.

Krahas masave sociale, Projektbuxheti 2027 vijon të mbështesë një program ambicioz investimesh publike, me fokus në projekte që përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve, nxisin rritjen ekonomike dhe përshpejtojnë integrimin evropian të vendit. Investimet do të përqendrohen në fusha prioritare si infrastruktura e transportit, dixhitalizimi i shërbimeve publike, arsimi, shëndetësia, bujqësia, zhvillimi rural dhe siguria, duke kontribuar në modernizimin e vendit dhe krijimin e më shumë mundësive për qytetarët

*Në shpenzimet e këtij funksioni që zënë rreth 5.2% të PBB, përfshihen kostot e funksionimit të administratës qendrore dhe vendore, shpenzimet e interesave, fondi i veçantë i pagave dhe shpenzimet e të ardhurave të tjera jashtë limitit

POLITIKAT PRIORITARE DHE FINANCIMI PËR REALIZIMIN E TYRE

Shtyllat kryesore për përmirësimin e jetesës së grave dhe burrave të të gjitha grupeve sociale në Shqipëri do të jenë: mbrojtja sociale, arsimi, shëndetësia, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional të të rinjve dhe të rejave, mbështetja proaktive ndaj biznesit, sidomos atij rural dhe turizmit.

EKONOMIA

TURIZMI


NXITJA E PUNËSIMIT DHE ARSIMIT PROFESIONAL TË TË RINJVE

MBËSHTETJA PRO-AKTIVE NDAJ BIZNESIT

ARSIMI

SHËNDETËSIA

MBROJTJA SOCIALE





BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Buxheti i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është planifikuar në masën **17.94 miliardë lekë.**

1. Prioritetet e sektorit të bujqësisë

- Konsolidimi i pronësisë mbi tokën bujqësore, administrimi i qëndrueshëm, ruajtja e saj nga dëmtimi, gërryerja, shpërdorimi dhe faktorë të tjerë.
- Mbështetje financiare dhe asistencë teknike për fermerët.
- Mbështetje për agroindustrinë.
- Garantimi i sigurisë ushqimore, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve, dhe shëndetit të bimëve përmes adoptimit të standardeve përkatëse të BE-së në kuadrin normativ vendas.



- Nxitja e tregut të tokës dhe konsolidimi i fermës bujqësore duke rritur sipërfaqen dhe nxitur kooperimin.
- Administrimi i sistemit të ujitjes nëpërmjet kujdesit, sigurimit dhe administrimit të qëndrueshëm të sistemit të ujitjes dhe shmangia e përmbytjeve.
- Mbështetje për tregjet dhe marketingun e produkteve bujqësore dhe blegtorale.
- Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të peshkimit dhe akuakulturës, shfrytëzimi i përgjegjshëm të burimeve peshkore dhe kapaciteteve të flotës së peshkimit si dhe ngritjen e një sistemi kontrolli dhe inspektimi për peshkimin në det, në tokë dhe në të gjithë zinxhirin e tregut.

ZHVILLIMI RURAL



Sa i përket politikave të zhvillimit rural, prioritet do të kenë edhe:

- Rritja e numrit të grave që përfitojnë shërbimet e këshillimit dhe informacionit bujqësor- ku 560 gra do të përfitojnë shërbime të targetuara informacioni dhe këshillimi bujqësor me një fond prej 2,600,000 lekësh.

- Shtimi i numrit të përfituesve nga masat mbështetëse në bujqësi në 43 666 përfitues në vitin 2027.

- Aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agro-përpunim.

- Rritjes së numrit të fermave organike të mbështetura nga 120 ferma në vitin 2027, në 130 ferma në vitin 2028 dhe 140 ferma në vitin 2029.

- Rritja e volumit të eksportit të produkteve bujqësore dhe të agro-përpunimit nga 59.7 miliardë lekë në vitin 2027 në 64 miliardë lekë në vitin 2029.

- Kompesimi i TVSH 10% për fermerët (3 miliardë lekë);

- Rritja e përqindja e sipërfaqes ujitëse ku fermerët kanë akses në ujë për ujitje, kundrejt sipërfaqes potencialisht të ujitshme (360 000 ha).

- Numri i të punësuarve në bujqësi dhe agro-përpunim (nga 438 000 të punësuar të parashikuar në vitin 2027 në 444 000 të punësuar në vitin 2029).



MBËSHTETJA E ZHVILLIMIT EKONOMIK

Prioritetet sa i përket mbështetjes së zhvillimit ekonomik do të jenë:



- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në panaire ndërkombëtare dhe “road show” promovuese, vizita në kompani (after care), në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve (BIDS) 2021-2027.

- Ndërmarrja me sukses e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe të produkteve “Made in Albania".



- Marrja e masave për të rritur konkurrueshmërinë e mikro-ndërmarrjeve, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nëpërmjet aksesit në financë përmes Fondit të Zhvillimit për ndërmarrjet, të parashikuar në ligjin nr. 43/2022 "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme".

- Nxitja e bashkëpunimit midis institucioneve arsimore dhe bizneseve, përmes aksesit të lehtë të informacionit.

- Zhvillimi i një qasje gjithëpërfshirëse në mbështetje të Ndërrmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) në integrimin e zinxhirit të vlerave globale përmes pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin Evropian të Tregut të Përbashkët 2021-2027, në shtyllën e NVM-ve.

INFRASTRUKTURA DHE ENERGJIA

Buxheti në dispozicion për prioritetet në këtë fushë është rreth 75.4 miliardë



- Rritja e numrit të përfituesve direkt dhe indirekt si përdorues të rrjetit rrugor, nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;
- Zgjerimi i aksesit si dhe rritja e cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes investimeve publike; dhe përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionare të ujësjellës kanalizimeve, duke standardizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
- Rritja e eficiencës së energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme.

Në programin e rrugëve kombëtare do të financohen me prioritet:

- Mirëmbajtja sipas standardeve të 3,522 km rrugë në territorin e Republikës së Shqipërisë, me fond total mesatar për shpenzimet e mirëmbajtjes prej 3.6 miliardë lekë.

- Financimi i rrugës Elbasan-Lekaj, bypass-i i Elbasanit, Elbasan-Qafë Thanë, zgjerimi Tiranë-Durrës, Tiranë-Ndroq-Plepa dhe bypass-i i Tiranës



Shërbimet për ujësjellës - kanalizime do të vijojnë të financohet për të përmirësuar treguesit, si më poshtë:

- Orët mesatare të furnizimit me ujë të pijshëm synohet të rritet në 24 orë/dite në vitin 2029 nga 22 orë/ditë në vitin 2027;
- Orët e furnizimit me ujë në zonat bregdetare synohet të arrihet në 23 orë/ditë në vitin 2029 nga 21 orë/ditë në vitin 2027;
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë Urbane në 98% në vitin 2029 nga 96% në vitin 2027;
- Mbulimi me shërbim furnizimi me ujë të pijshëm zonë Rurale 80% në vitin 2029 nga 70% në vitin 2027;



Planifikimi urban do të synojë më shumë lëvizshmëri dhe infrastrukturë të sigurt, përmes:

- Zhvillimit të qëndrueshëm dhe të balancuar të territorit, duke zbutur pabarazinë rajonale;
- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës - Terminali pasagjerëve Tiranë dhe ndërtimi i linjës hekurudhore Tiranë – Rinas;
- Rehabilitimi i linjës hekurudhore Vore - Hani i Hotit



SHËNDETËSIA

Politikat prioritare të zhvillimit të shëndetësisë do të financohen me rreth 87.2 miliardë lekë.



- Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore).

- Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare të institucioneve shëndetësore e të mbrojtjes sociale, nëpërmjet përdorimit më efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve.
- Rreth 400 mijë qytetarë do të përfitojnë barna të rimbursueshme, përfshirë edhe barna për trajtimin e sëmundjeve tumorale, duke siguruar akses më të lehtë në mjekimet e nevojshme.
- Do të financohen paketat e shërbimeve spitalore në spitalet publike dhe private, në mënyrë që qytetarët të marrin trajtimet e nevojshme, përfshirë edhe paketën e re për trajtimin e trombektomisë.
- Vizita të detyrueshme nga personeli shëndetësor për 28 mijë fëmijë të moshës 0-1 vjeç;
- Gjatë periudhës 2027-2029 parashikohen të vaksinohen për gripin sezonal rreth 300,000 persona/çdo vit me një fond respektivisht prej 171 milion lekë;
- Rimbursimi i fishave të diabetit për 67 mijë përfitues;
- Financimi i zgjerimit dhe rehabilitimit të më shumë se 20 spitaleve në vend; (Spitali rajonal Korçë, Pogradec, Lushnje, Mat, Dibër, Gjirokastër, etj).

Politikat shëndetësore do të vijojnë të mbështesin nënat e reja me shërbime të shëndetit parësor dhe dytësor, ku rëndësi të veçantë zënë investimet në maternitete me rreth 771 milionë lekë për vitin 2027.

- Depistimi për kancerin e gjirit për 5 000 gra përgjatë 2027-2029 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i gjirit;
- Depistimi për kancerin e qafës së mitrës për 12 500 gra përgjatë 2027-2029 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës;
- Financimi i shërbimit të ndërhyrjes së rikonstruksionit të gjirit për 350 paciente në vit gjatë periudhës 2027-2029, me një fond prej 70 milionë lekë në vit, në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së grave të trajtuara për kancer gjiri
- Financimi i paketës së fertilitetit për çiftet që kanë nevojë për trajtim të infertilitetit, me një fond prej 37.5 milionë lekë në vit dhe 200 çifte përfituese çdo vit gjatë periudhës 2027-2029.



ARSIMI




3.2% e PBB

Fondet për sektorin e Arsimit në vitin 2027, parashikohet të arrijnë në 93.7 miliardë lekë.

Politikat kryesore për zhvillimin e arsimit gjatë këtij viti synojnë:

- Ofrimin e teksteve shkollore falas për 215 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe ofrimi i bursave financiare apo kuotë ushqimore/financiare për 4000 nxënës me nevoja të veçanta;
- Tekstet shkollore falas për arsimin e mesëm ku do të përfitojnë 16,000 nxënës dhe vajzat që vijnë nga familje në nevojë dhe/apo viktima të trafikimit;
- Sigurimin e shërbimit të transportit për 38 mijë vajza dhe djem që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, si dhe për rreth 17 000 mësues/e që punojnë mbi 5 km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë;
- Financimi i programit pilot të kujdesit passhkollor (after school)





Punësimi dhe aftësimi profesional

Politikat e punësimit dhe të arsimit profesional për gratë dhe vajzat vijojnë të jenë prioritet, ashtu sikurse edhe politikat e mbrojtjes sociale të strehimit social apo të sigurimeve shoqërore, të cilat synojnë jo vetëm fuqizimin, por edhe ndihmën specifike ndaj atyre që janë viktima të dhunës më baza gjinore apo në familje.

- Modernizimi i infrastrukturës së ofruesve publik të AFP-së, në përputhje me parimet e ekonomisë dhe transformimit digjital;
- Rritja e aksesit në Arsimin e Mesëm Profesional duke synuar që deri në vitin 2029 të tërhiqen 23% e nxënësve që ndjekin ciklin e Arsimit e Mesëm, nga 19% që parashikohet në vitin 2027;
- 70% e Punëkërkuesve të papuna gra parashikohet të mbahen në punë pas përfundimit të programit të nxitjes së punësimit në vitin 2027;
- 510 të rinj vajza e djem përfitues të nismës Garancia Rinore;
- 13,350 të trajnuar në Qendrat e Formimit Profesional Publik;

MBROJTJA SOCIALE

Projektbuxheti 2027 garanton rritjen e qëndrueshme të mburojës sociale për shtresat në nevojë, me fokus fëmijët, nënat më shumë fëmijë, të moshuarit dhe familjet.

- Buxheti për programet e mbrojtjes sociale garanton mbështetjen e 59 mijë familjeve ër vitin 2027, pjesë e programit të ndihmës ekonomike, ku rreth 40% të përfituesve janë gra të dhunuara.



- Mbështetje për programin e pagesave për 99 mijë përfitues me aftësi të kufizuar dhe kujdestarët e tyre.
- Vijon financimi i politikës së mbështetjes së veçantë për gratë e papuna me 3 apo më shumë fëmijë deri 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100 mijë lekë në muaj, duke i mbështetur me pagesën e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri 5 vjeç. Për vitin 2027 parashikohet të përfitojnë 8 500 gra me një kosto prej 870,000,000 lekësh.

- Mbështetje për skemën e pensioneve për 805 mijë përfitues për vitin 2027;
- Në shpenzimet buxhetore për periudhën 2027-2029 sigurohen burimet e nevojshme për arritjen e angazhimit të Qeverisë për rritjen e pensionit minimal në nivelin e 200 Euro në muaj dhe atij mesatar në nivelin e 400 Euro në muaj.

- Financimi i politikës së rishikuar të bonusit të bebes nga e cila pritet të përfitojnë fëmijë të moshës 0-5 vjeç duke dhënë një pagesë mujore që varion nga 5,000-10,000 lekë/muaj
- Financimi i pagesave të barrëlindjes për prindërit përfitues, në përputhje me skemën e sigurimeve shoqërore, për të mbështetur mirëqenien e familjeve dhe të fëmijëve.

DREJTËSIA DHE RENDI

2.2% e PBB

Shpenzimet buxhetore për funksionin e Drejtësisë dhe Rendit Publik parashikohen në masën 65.5 miliardë lekë.

- Sigurimi i kushteve të përshtatshme për rreth 5,500 të dënuar burra, 86 të dënuar gra dhe 36 të dënuar të mitur, si dhe trajtimin me shërbim shëndetësor për 438 të dënuar të sëmurë, me fondin total në rreth 2.3 miliardë lekë.
- Ri-integrimi nëpërmjet zhvillimit të programeve për rehabilitimin në shoqëri të paraburgosurve dhe të dënuarve në përputhje me standardet evropiane, për rreth 360 të dënuar burra, 2 gra dhe 6 të mitur.
- Ofrimi i ndihmës juridike falas për rreth 6,000 individë në total, që plotësojnë kushtet në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas, prej të cilëve 3,000 ose 50% të totalit, gra dhe vajza.
- Realizimi i rreth 19,200 akteve të ekspertimit të klasifikuara si; mjeko-ligjore, toksikologjiko-ligjore, biologjiko-ligjore dhe psikiatriko-ligjore, në përputhje me standardet europiane.



- Mbikëqyrja në mënyrë efektive e 8000 burrave, 850 grave dhe 250 të miturve gjatë shërbimit të provës.
- Realizimi i skemës së shpërndarjes së Fondit Special të Kompensimit nga 926 vendime të trajtuara me kompensim kundrejt totalit të vendimeve të Regjistrit elektronik të ATP-së të parashikuar për vitin 2027, në 1,176 për vitin 2029;
- Garantimi i interesit më të lartë të fëmijëve, nëpërmjet vendosjes në familje të përhershme që përshtaten me nevoja specifike të secilit prej tyre, me synimin që 100% e totalit të birësimeve të rezultojnë të suksesshme
- Rritja e nivelit të pagave për gradë për punonjësit e Policisë së Shtetit nga 10,000-20,000, nga e cila pritet të përfitojnë rreth 12 432 punonjës.
- Reduktimi i kohës së reagimit ndaj krimeve të dhunës në familje 13 minuta në vitet 2027-2029.



Buxheti i vitit 2027 i Ministrisë së Mbrojtjes arrin në 76.61 miliardë lekë nëpërmjet të cilit garantohet:

- Lartësimi i figurës dhe integritetit të ushtarakëve gra dhe burra.
- Aktiviteti i personelit për 755 ushtarakë të forcave ajrore, 1,350 personel i Forcave të Armatosura, ku rreth 15% e tyre janë gra dhe vajza me dhe pa uniform.
- Numri i pacientëve të shtruar të planifikuar dhe urgjente në Spitalin e Traumës parashikohet mesatarisht 98 502 pacientë.
- Mbështetje për aktivitetin e 735 punonjësve të arsimuar sipas kritereve dhe standarteve të NATO-s.
- Shpenzimet thelbësore për mbrojtjen parashikohen në 2.35% të PBB, ndërkohë që duke përfshirë dhe shpenzimet të tjera të lidhura me mbrojtjen buxheti shkon në 2.61%.
- Trajtim i veçantë për 32 604 ushtarakë në rezervë dhe në lirim.
- Numri i operacioneve të planifikuara dhe urgjence parashikohet mesatarisht 69 mijë operacione në Spitalin e Traumës.
- Modernizimi me armatim të lehtë dhe municione i Forcave të Armatosura.



- Zbatimi në mënyrë cilësore i detyrimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja dhe anëtarësia në organizma të niveleve të larta ndërkombëtare si: NATO, EAPC, RACVIAC, etj. i realizuar nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në kuadër të partneritetit mes vendeve, rritjes së sigurisë në rajon e më gjerë.

ARGËTIMI, KULTURA DHE ÇËSHTJET FETARE

0.5% e PBB

Shpenzimet për funksionin e argëtimit, kultura dhe çështje fetare parashikohet të arrijnë në 14.2 miliardë lekë, duke synuar financimin e projekteve me rëndësi për ruajtjen e kulturës dhe traditës, bashkëjetesës fetare, zhvillimit të artit dhe shtimin e turizmit kulturor në Shqipëri.



- Restaurimi dhe mirëmbajtja e trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit, duke përfshirë restaurimin e disa linjave muzeale, si edhe përshtatjen me standarde bashkëkohore. Parashikohen rreth 156 objekte të trashëgimisë arkitektonike dhe peisazhit të restauruara dhe mirëmbajtura në periudhën 2027-2029.

- Rritja e mbështetjes për aktiviteteve të fushës së trashëgimisë kulturore rreth 130 aktivitete të mbështetura financiarisht në vitet 2027-2029.

- Rritja e numrit të objekteve të regjistruara në databazën kombëtare të trashëgimisë, rreth 140 mijë në vitet 2027 – 2029.

- Rritja e numrit të projektve me thirrje në mbështetje e industrive krijuese duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e margjinalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi nga 278 në vitin 2027, në 280 në vitin 2028 dhe 285 në vitin 2029.

- Ndërtimi i Godinës sëTeatrit Tiranë.

- Zhvillimi i rreth 720 aktiviteteve të kalendarëve artistik të programuara nga institucionet qendrore publike të artit dhe kulturës.

- Mbështetja e skenës së pavarur për të mundësuar edukimin përmes kulturës, si dhe përfaqësimi i produktit artistik në arenën elitare ndërkombëtare.

- Restaurimi, rikonstruksioni, riformulimi i Linjës muzeore në Muzeun Historik



Në sektorin e kulturës do të vijohet t'i jepet përparësi:

- Grave dhe vajzave artiste që promovojnë skenën e pavarur;
- Grave dhe vajzave artizane që ruajnë dhe trashëgojnë më tej vlerat dhe traditat e kulturës shqiptare.

MBROJTJA E MJEDISIT

Duke marrë gjithnjë e më tepër vëmendje e rëndësi në mënyrën se si aktivitetet e ndryshme publike ndikojnë në mjedis, efektet e ndryshimeve klimatike, si dhe krijimin e vendeve të reja të punës apo mundësitë në investime në "ekonominë e gjelbër", ky sektor do të financohet me 8.7 miliardë lekë ose 0.3% të PBB-së dhe do të fokusohet ndër të tjera edhe në:

- Arritjen e përmirësimeve të matshme të cilësisë së ajrit sipas përcaktimeve në strategjinë kombëtare të ajrit.
- Përmirësimin e performancës së menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit me qëllim përmirësimin.
- Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura
- Rritja e përqindjes së mbetjeve të trajtuara me standarde kundrejt sasisë totale të mbetjeve të prodhuara synon rritjen në 75% gjatë periudhës
- Rritja e impianteve rajonale të trajnimit të mbetjeve të ndërtuara kundrejt totalit të nevojshëm për trajtimin e të gjithë mbetjeve të prodhuara në 90% ndaj periudhës.
- Menaxhimi i zonave të mbrojtura përforcohet përmes zgjerimit të aktiviteteve monitoruese, rreth 32,200 monitorime çdo vit.
- Përmirësimi i cilësisë së mjedisit, duke arritur një ulje të ndotjes akustike në zonat urbane.

STREHIMI



Objektivi i këtij programi është të sigurojë, deri në vitin 2030, strehim të përshtatshëm e të përballueshëm për rreth 35,000 individëve/familjeve që kanë aplikuar për strehim dhe që nuk përballojnë dot kostot e tregut të banesave.

Për vitin 2027 parashikohen 1.2 miliardë lekë të cilat do të financojnë:



- Pagesën e bonusit të qirasë për rreth 2,000 familje përfituese me një fond prej 262 milionë lekë.

- Skemat e investimeve për përmirësimin e kushteve të jetesës për gra dhe burra nga grupet sociale, parashikohen mesatarisht 350 familje përfituese në nevojë, me një kosto prej 350 milion lekë.

- Adaptim i 37 godinave në pronësi të Njësive të Qeverisjes Vendore për strehim social me një fond prej 150 milion lekësh.

- Për gratë dhe vajzat e dhunuara, apo familje një prindërore, do të vijohet mbështetja me strehim social. Kostoja për strehimin social të 2200 grave dhe vajzave të kategorisë së përcaktuar sipas ligjit do të 166,164,706 lekë, përllogaritur si përpjesë e dy produkteve kryesore të skemave.

DEFICITI BUXHETOR DHE BORXHI PUBLIK

Deficiti buxhetor për vitin 2027 planifikohet të jetë në nivelin 2.3% të PBB. Balanca primare pritet të jetë e balancuar për vitin 2027.

Konsolidimi fiskal vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2027-2029, në funksion të ruajtjes së stabilitetit të financave publike dhe të uljes graduale të borxhit publik

Në vitin 2026 parashikohet që borxhi publik bruto të ulet në rreth 52.5 përqind të PBB-së dhe pritet të vijojë të bjerë më tej në rreth 52.4 përqind në vitin 2027. Sipas skenarit bazë, borxhi publik bruto pritet të bjerë në rreth 52.2 përqind deri në vitin 2029 dhe më tej në rreth 50.9 përqind në vitin 2031.


	2023	2024	2025	2026*
Shqipëria	57.6	54.2	52.9	52.7
Bosnja dhe Hercegovina	28.5	27.2	26.8	26.1
Kosova	17.5	17.2	17.1	17.5
Maqedonia	57.8	61.4	59.3	59.4
Mali i Zi	59.9	61.2	65.2	67.5
Serbia	48.4	47.3	45.0	44.9
Mesatarja e rajonit	44.9	44.8	44.4	44.7

DEFICITI

2.3

BORXHI

52.4



Copyright: Ministria e Financave
Credits: Besjon Tanuzi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE